



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 5 qershor 2023
Nr. ref.:RK 2201/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI71/23

Parashtrues

Mehmet Hoti

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit PML. nr. 31/2023 të 23 shkurtit 2023 të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Mehmet Hoti (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), nga fshati Marinë, komuna e Skenderajt, tani me banim në Fushë Kosovë, i cili përfaqësohet nga Hajzer Salihu, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [PML. nr. 31/2023] të 23 shkurtit 2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktgjykimin [PAKR. nr. 638/2022] e 30 nëntorit 2022 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [P. nr. 961/2013] e 21 tetorit 2022 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 36.2 [E Drejta e Privatësisë], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në lidhje, dhe me nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).
4. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), vendosjen e masës së përkohshme, për të pezulluar ekzekutimin e vuajtjes së dënimit, deri në vendosjen e meritave të kërkesës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], paragrafin 2 të nenit 116 [Efektet Juridike të Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 27 (Masat e përkohshme) dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 28 mars 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 30 mars 2021, Kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, me Vendimin GJR. KI71/23 caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH. KI71/23 caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Remzije Istrefi-Peci (kryesuese) Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci (anëtarë).
8. Më 12 prill 2023, Gjykata për regjistrimin e kërkesës njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
9. Më 22 maj 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës dhe refuzimin e kërkesës për masë të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

- a. *Hetimi dhe ngritja e aktakuzës*

10. Më 11 maj 2013, Policia e Kosovës bastisi shtëpinë e parashtruesit të kërkesës dhe objektet rreth saj, ku gjatë kontrollit i është gjetur dhe konfiskuar një sasi prej 628.96 gram, e lëndës narkotike e llojit marihuanë.
11. Më 24 dhjetor 2013, Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti për krime të rënda, ndaj parashtruesit të kërkesës ngriti aktakuzën [PP. I. nr.84/2013] nën dyshimin e bazuar se kishte kryer veprën penale “*Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge*” nga neni 273, paragrafi 1, i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK).
12. Më 31 janar 2018, Gjykata Themelore mbajti seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën parashtruesi i kërkesës kërkoi që aktakuza e ngritur kundër tij të hidhej poshtë si e pabazuar.
13. Më 6 prill 2018, Gjykata Themelore nëpërmjet Aktvendimit P. nr. 961/13, e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesë për hedhje poshtë të aktakuzës.
14. Kundër aktvendimit të lartcekur, parashtruesi i kërkesës në afat ligjor kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila më 4 maj 2018, me Aktvendimin Pn. nr. 376/2018, e refuzoi ankesën e tij dhe konfirmoi Aktvendimin e 6 prillit 2018 të Gjykatës Themelore.

b. Gjykimi i rastit penal (mjetet e rregullta të goditjes)

15. Më 21 tetor 2022, Gjykata Themelore, nëpërmjet Aktgjykimit [P. nr. 2961/2013], e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale “*Blerje, posedim, shpërndarje dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge*” nga neni 273, paragrafi 1, i KPRK-së, për të cilën e dënoi me burgim efektiv në kohëzgjatje prej një (1) viti, e gjashtë (6) muajve, si dhe me dënim me gjobë në shumën prej 800 (tetëqind) euro, nën kërcënimin se në rast të mos pagesës së gjobës, dënimi do t’i zëvendësohej me burgim efektiv. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, Gjykata Themelore theksoi: “*Gjykata bazuar në të lartcekurat, lidhur me të gjeturat e saj në vlerësim të rrethanave të rastit, siç janë sasia e substancës narkotike dhe mënyra se si është gjetur e paketuar ka arritur në konkluzionin e saj në drejtim të vërtetimit përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari substancën narkotike e ka pasur me qëllim shitje, shpërndarje, a ofrim për shitje si elemente të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273, par. 1 të KPRK-së,...*”.
16. Më 7 nëntor 2022, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe shkeljes së ligjit penal. Pretendimi kryesor i parashtruesit të kërkesës ishte se policia në kundërshtim me ligjin bastisi shtëpinë e tij, dhe më pas nëpërmjet telefonit kërkoi lëshimin e urdhrit verbal nga gjyqtarja e procedurës paraprake për të legjitimuar bastisjen.
17. Më 24 nëntor 2022, Prokurori i Apelit i propozoi Gjykatës së Apelit që të refuzonte ankesën e parashtruesit të kërkesës, si të pabazuar, dhe të konfirmonte Aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë.
18. Më 30 nëntor 2022, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin [PAKR. nr. 638/2022], refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe konfirmoi Aktgjykimin [P. nr. 2961/2013] e Gjykatës Themelore, me arsyetimin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk

përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilave u referohet mbrojtësi në ankesë, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i qartë i kuptueshëm dhe konkret, po ashtu i njëjti është në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin dhe gjithashtu edhe përpilimi është bërë konform dispozitave të nenit 370, paragrafi 4, lidhur me nenin 365 të KPPRK-së, ku janë përfshirë të gjitha faktet dhe rrethanat nga të cilat plotësohen elementet e veprës penale nga neni 273, paragrafi 1 i KPRK-së, për të cilin parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor.

c. Mjeti i jashtëzakonshëm (KML)

19. Më 16 janar 2023, parashtruesi i kërkesës nëpërmjet mbrojtësit të tij parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit, me pretendimin për shkelje të ligjit penal dhe procedural.
20. Më 2 shkurt 2023, Kryeprokurori i Shtetit i propozoi Gjykatës Supreme që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar.
21. Më 23 shkurt 2023, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin [Pml. nr. 31/2023], refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konfirmoi aktgjykimet e instancave më të ulëta. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme, ndër të tjera arsyetoi: *“Me këto konkludime të gjykatës së shkallës së parë, të cilat janë konfirmuar edhe nga gjykata e shkallës së dytë, pajtohet edhe Gjykata Supreme e Kosovës, andaj edhe si rezultat i kësaj, rezulton se në veprimet e të dënuarit Mehmet Hoti qëndrojnë të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën është shpallur fajtor, siç është përshkruar në mënyrë të hollësishme në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.*

d. Procedura lidhur me ekzekutimin (vuajtjen) e dënimit

22. Më 6 janar 2023, Gjykata Themelore ndaj parashtruesit të kërkesës lëshoi Urdhrin ED. nr. 04/2023 për vuajtjen e dënimit në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, e 6 (gjashtë) muaj, në përputhje me Aktgjykimin e formës së prerë.
23. Më 6 janar 2023, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të Urdhrit ED. nr. 04/2023 të 6 janarit 2023, për arsye shëndetësore, gjegjësisht të trajtimit të sëmundjes së bronhititit.
24. Më 6 shkurt 2023. Gjykata Themelore, aprovoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për shtyrjen e vuajtjes së dënimit vetëm për 3 (tre) muaj, gjegjësisht deri më 8 maj 2023.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 36.2 [E Drejta e Privatësisë], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës, si dhe nenin 6.1 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor) të KEDNj-së.

i. Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 36.3 të Kushtetutës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta nuk morën parasysh pretendimin e tij se autoritetet e hetuesisë, gjegjësisht prokuroria dhe policia, nuk kishin vepruar në pajtueshmëri me procedurat e parapara me KPPRK-në dhe me dispozitat kushtetuese, kur bastisën shtëpinë e tij. Më saktësisht, parashtruesi i kërkesës thekson: *“Instancat gjyqësore, të cilave ju kemi drejtuar në lidhje me trajtimin e institutit kushtetues dhe ligjor URDHRI SHKRESOR PËR APROVIMIN RETROAKTIV, i cili duhet të aplikohet në rastet kur kontrolli i pronës kryhet përmes urdhrin verbal, kanë përdorur të njëjtin arsyetim ligjor, duke pranuar si të mirëqenë shkrimin me dorë nga Gjykata në një Shënim Zyrtar të Policisë, duke anashkaluar kështu depozitën kushtetuese: Neni 36, paragrafi (2) [E Drejta e Privatësisë], si dhe dispozitat e KPPRK-së.”*
27. Parashtruesi i kërkesës tutje thekson se *“... procedura e marrjes së provave nga organi i akuzës (prokuroria) në bashkëpunim me policinë, paraqet një procedurë tejet formale, ku konform nenit 7 të KPPRK-së, Prokurori i Shtetit dhe Policia e Kosovës, të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm. Ata më tutje detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit, si dhe ato në favor të tij, dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t'i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të të pandehurit, ndërsa në këtë çështje penale, kjo fazë e parapare me Kodin e Procedurës Penale është zhvilluar në mënyrë të kundërligjshme dhe jashtë dispozitave që i parasheh Kodi i lartcekur, rrjedhimisht duke i shkelur të njëjtat norma, e kjo për faktin se: Më 11 maj 2013, ka ndodhur bastisja, ku nga Policia e Kosovës është nxjerrur një shënim zyrtar, ku konstatohet se rreth orës 19:50 është njoftuar nëpërmjet telefonit gjyqtarja e procedurës paraprake në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, dhe prej të njëjtës kanë kërkuar URDHRI VERBAL të bastisjes në shtëpinë dhe objektet përcjellëse të personit të dyshuar Mehmet Hoti, ku të njëjtit i është gjetur substanca e marhuanës me peshë 628.96 gram.*
28. Parashtruesi i kërkesës në vazhdim pretendon se janë të kundërligjshme dhe kontradiktore shënimet që përmban shënimin zyrtar, me ato të procesverbalit të bastisjes dhe me veprimet që janë marrë në të vërtetë, sepse nga procesverbali i bastisjes, i 11 majit 2013 shihet se bastisja ka filluar rreth orës 20:00 dhe ka përfunduar në orën 20:50, ndërsa në shënimin zyrtar të 11 majit 2013, thuhet se ka përfunduar në orën 22:00. Sipas tij nga gjyqtarja e procedurës paraprake e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, urdhri verbal i bastisjes është kërkuar me telefon rreth orës 19.50. Megjithatë, nga shënimin zyrtar i policisë i 11 majit 2013, parashtruesi i kërkesës thekson se gjyqtarja e procedurës paraprake në fund të kësaj shkrese, me dorëshkrimin e saj të lirë ka shënuar: *“Konfirmoj se e kam dhënë në ora 22 e 24 min, urdhërin gojor për kontroll”,* që sipas tij, bastisja në shtëpinë e tij dhe objektet përcjellëse është kryer nga ana e policisë pa pasur fare as urdhër gojor dhe as me shkrim.
29. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendon se edhe pas marrjes së urdhrin verbal, gjyqtarja e procedurës paraprake nuk ka vepruar në përputhje me procedurat e paraprake për nxjerrjen Urdhrin shkresor dhe aprovimin retroaktiv të të njëjtit, duke shkelur kësaj dispozitat e nenit 110, paragrafi 6 të KPPRK-së, që përcakton se *“Kur policia ndërmerr kontroll pa urdhër të shkruar gjyqësor, brenda afatit prej dymbëdhjetë orësh pas kontrollit i dërgon raport lidhur me këtë Prokurorit të Shtetit dhe gjyqtarit kompetent nëse për këtë çështje është caktuar ndonjë gjyqtar në mënyrë që të merret aprovimi retroaktiv gjyqësor' i kontrollit, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës”.*

30. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se veprimet e policisë dhe të prokurorisë, në lidhje me zbatimin e procedurës së përcaktuar hetimore dhe të marrjes së provave janë aprovuar si të ligjshme nga të gjitha instancat gjyqësore në kundërshtim edhe me nenin 111, paragrafi 1.1, 1.2, 1.3, dhe 1.4 i KPPRK-së.
31. Parashtruesi i kërkesës pretendon se miratimi i një prove thelbësishtë të pambështetur, si të pranueshme nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe konfirmimi i saj edhe nga gjykata e shkallës së dytë dhe tretë, është në kundërshtim edhe me vetë provizionet kushtetuese të cilat në mënyrë taksative e rregullojnë këtë çështje, respektivisht neni 36 [E drejta e Privatësisë], paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcakton se: "Kontrollet e cilësdo banesë ose cilitdo objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimit, mund të bëhen vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe vetëm pas miratimit nga ana e gjykatës, pas shpjegimit të arsyeve pse një kontroll i tillë është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
32. Mbi këtë bazë, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykata duhet të miratojë veprimet e tilla në mënyrë retroaktive sepse pjesa e fundit e këtij paragrafi krijon obligim ligjor për gjykatën që e njëjta t' i miratojë veprimet e kontrollit/bastisjes në mënyrë retroaktive, ku këto veprime nuk kanë ndodhur, dhe rrjedhimisht e njëjta provë do të duhej të konsiderohej e papranueshme, mbi bazën e nenit 111, paragrafi 1, pika 1.1 të Kodit të Procedurës Penale, e po ashtu konsiderojmë se urdhri për t'u konsideruar i ligjshëm do të duhej të ishte në formë shkresore, përshtatshmërisht duke përmbytur elementet nga neni 105, paragrafi 7 të KPPRK-së.
33. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës në këtë vazhdë, thekson: *"Ajo çfarë ne kemi ngritur gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor në Gjykatën Themelore, por edhe me ankesën tonë në Gjykatën e Apelit, dhe Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, nuk ka qenë çështje kontestuese dhënia e urdhrit me gojë, dhe as konfirmimi në Shënimin Zyrtar të Policisë, se ajo e ka dhënë një aprovim gojor, por ka qenë pretendimi ynë i bazuar në normën kushtetuese dhe ligjore, pikërisht tek forma se si është bërë URDHRI SHKRESOR PËR APROVIMIN RETROAKTIV, i cili siç e kemi theksuar edhe më lart nuk përmban asnjë nga elementet e kërkuara me dispozitat kushtetuese dhe të Kodit të Procedurës Penale, përfshirë këtu edhe kohën e nxjerrjes së tij, pasi që konsiderojmë se në një Shënim Zyrtar të prodhuar nga Policia e Kosovës, mbishkrimet e gjykatës në atë shënim janë jo ligjore, jo etike nga aspekti profesional, pasi që lënë dyshime të mëdha se kur, kush, dhe si mund të jetë shkruar mbi atë shënim".*

ii. *Pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 54 dhe 55 të Kushtetutës*

34. Parashtruesi i kërkesës përveç faktit që iu është referuar këtyre neneve të Kushtetutës dhe të instrumenteve ndërkombëtare të aplikueshme në rendin juridik të brendshëm të Republikës së Kosovës, nuk dhënë sqarim dhe arsyetim se si janë shkelur ato nga ana e autoriteteve publike dhe gjykatave të rregullta respektive.
35. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata: të shpallë të pranueshme këtë kërkesë; të vendos masë të përkohshme, deri në zgjidhjen e meritave të rastit në mënyrë që të evitohen dëmet e mundshme të pariparueshme, ose nëse e njëjta vendoset në favor të palës kërkuese, të vazhdohet deri në vendosjen sipas *ratio decidendi* të Gjykatës; të shpallë

Aktgjykimin [PML.nr. 31/2023] e Gjykatës Supreme, Aktgjykimin [PAKR. nr. 638/2022] e Gjykatës së Apelit, dhe Aktgjykimin [P.nr.961/13] e Gjykatës Themelore, kundërkushtetues; të shpallë kundërkushtetues Urdhrin Shkresor për Aprovim Retroaktiv të dhënë mbi Shënimin Zyrtar të Policisë së Kosovës, të 11 majit 2023 dhe Procesverbalin për bastisjen e banesës dhe personave të 11 majit 2023.

Arsyetimi i kërkesës për vendosje të masës së përkohshme

36. Parashtruesi i kërkesës, arsyetimin e kërkesës për vendosjen e masës së përkohshme e mbështet në faktin se Gjykata Themelore në Mitrovicë ka lëshuar Urdhrin ED. nr. 04/2023 për vuajtje të dënimit, në kohëzgjatje 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, “... duke besuar se dënimi është shqiptuar mbi një aktgjykim kundërkushtetues, të bindur se zbatimi i një aktgjykimi i cili bazën e shqiptimit të dënimit e ka mbi një provë antikushtetuese dhe antiligjore, do të privonte parashtruesin nga liria padrejtësisht me plot 1 vit e 6 muaj, dhe do të shkaktonte dëme të pariparueshme për parashtruesin e kësaj kërkesë,”.

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
- [...]

Neni 36

[E Drejta e Privatësisë]

- [...]
2. Kontrollat e cilësdo banesë ose cilitdo objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimit, mund të bëhen vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe vetëm pas miratimit nga ana e gjykatës, pas shpjegimit të arsyeve pse një kontroll i tillë është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Gjykata duhet që të miratoj veprimet e tilla në mënyrë retroaktive.
 3. Fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit tjetër, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligj.
- [...]

Neni 54

[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Neni 55 **[Kufizimi i të drejtave dhe Lirive Themelore]**

1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.
2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.
3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.
4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.
5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësi esencën e së drejtës së garantuar.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 **(E drejta për një proces të rregullt)**

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]

Kodi nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës (2012)

Neni 273 **Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve,** **substancave psikotrope dhe analoge**

1. Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet .
2. Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon ose dërgon në transit substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë,

substancia psikotrope ose 103 substancia analoge, me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

3. Kushdo që pa autorizim eksporton ose importon substancia apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substancia psikotrope ose substancia analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.

4. Për qëllime të këtij kapitulli, shprehja "analog" nënkupton çfarëdo substance e cila nuk është e autorizuar dhe struktura kimike e së cilës është esencialisht e ngjashme me atë të substancave apo preparateve që janë shpallur si narkotikë ose substancia psikotrope dhe efektet e të cilave i riprodhon.

5. Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge dhe mjetet për prodhimin, shpërndarjen apo transportimin e tyre konfiskohen.

Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës (2012)

Neni 110

Arsyet për kontroll pa urdhër të gjykatës

1. Kur është e domosdoshme dhe në masë të nevojshme, zyrtarët policorë mund të hyjnë në shtëpinë dhe lokalet tjera të personit dhe të zbatojnë kontrollin pa urdhrin e gjyqtarit të procedurës paraprake nëse:

[...]

3. Përjashtimisht, në rrethana të ngutshme, kur urdhri me shkrim për kontroll nuk mund të merret me kohë dhe nëse ekziston rrezik real për vonesë, që mund të rezultojë me humbjen e provave, ose rrezik ndaj jetës ose shëndetit të njerëzve, zyrtari i autorizuar i policisë mund të fillojë kontrollin në bazë të lejes gojore nga gjyqtari kompetent.

[...]

6. Kur policia ndërmerr kontroll pa urdhër të shkruar gjyqësor, brenda afatit prej dymbëdhjetë (12) orësh pas kontrollit i dërgon raport lidhur me këtë Prokurorit të Shtetit dhe gjyqtarit kompetent nëse për këtë çështje është caktuar ndonjë gjyqtar në mënyrë që të merret aprovimi retroaktiv gjyqësor i kontrollit, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.

Neni 111

Pranueshmëria e provave të marra gjatë kontrollit

1. Provat e mbledhura nëpërmjet kontrollit janë të papranueshme nëse:

1.1. provat e marra gjatë kontrollit, pa lejen e gjykatës, janë të papranueshme, nëse kontrollimi nuk merr aprovim retroaktiv gjyqësor, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës;

[...]

Pranueshmëria e kërkesës

37. Gjykata së pari vlerëson nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.

38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

[...]

39. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

40. Rreth përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar dhe konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [PML. nr. 31/2023] e Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
41. Përveç kriterëve të lartcekura, Gjykata po ashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në nënregullin 2 të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

Rregulli 39
(Kriteret e papranueshmërisë)

2 Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

42. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*” (shih, rastet e GjEDNj-së, [Kemmache kundër Francës](#), nr. 17621/91, kategoria (i), [Juta Mentzen kundër Lituanisë](#), nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, kategoria (iii)).
43. Gjykata, fillimisht rikujton se në procedurën e shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, duke iu referuar praktikës së saj gjyqësore dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNj), thekson se ajo nuk është e kushtëzuar vetëm nga karakterizimi i shkeljeve që pretendon parashtruesi i kërkesës. Në frymën e parimit *juris novit curia*, Gjykata është vetë përgjegjëse për karakterizimin e çështjeve kushtetuese që mund t’i përmbajë një rast i veçantë dhe mund të shqyrtojë vullnetarisht ankesat përkatëse, bazuar në dispozita ose qëndrime që nuk thirren shprehimisht nga palët (shih, në këtë drejtim, rasti Gjykatës: [KI48/18](#), parashtrues: *Ahmet Frangu*, Aktgjykim i 22 korrikut 2020, paragrafi 81).
44. Përveç kësaj, sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, një ankesë karakterizohet nga faktet e përfshira në të, dhe jo vetëm nga baza ligjore dhe argumentet në të cilat palët thirren shprehimisht (shih, rastin e GjEDNj-së: [Talpis kundër Italisë](#), nr. 41237/14, Aktgjykim i 18 shtatorit 2017, paragrafi 77 dhe referencat e cituara aty).
45. Gjykata, duke iu rikthyer shqyrtimit të kërkesës rikujton se parashtruesi i kërkesës para Gjykatës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij, të garantuara me nenin 31, në ndërlidhje me nenin 36, dhe nenet 54 dhe 55 të Kushtetutës, si dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, për faktin se gjykatat e rregullta me vendimet e tyre konfirmuan veprimet kundërligjore të autoriteteve të hetuesisë dhe të gjyqtares së procedurës paraprake.

46. Nga shkresat e lëndës, dhe mënyra e argumentimit të kërkesës, Gjykata vëren se esenca e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në fakt ngrenë çështje të së drejtës për gjykim të drejtë, e cila ndërlidhet me ligjshmërinë e marrjes dhe të pranimit të provave nga ana e gjykatave të rregullta, duke e ndërlidhur ligjshmërinë e provave me veprimet e bastisjes së shtëpisë së tij.
47. Andaj, pretendimin kryesor dhe thelbësor të parashtruesit të kërkesës Gjykata do e shqyrtojë dhe analizojë nga pikëpamja e të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në dritën e interpretimit të nenit 6.1 të KEDNj-së, duke aplikuar parimet e përcaktuara nëpërmjet praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në bazë të të cilave Gjykata në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës është e obliguar që: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

i. Vlerësimi i Gjykatës, përkitazi me “ligjshmërinë e marrjes së provave”

a) Parimet e përgjithshme

48. Në vijim dhe në kontekst të pretendimit të parashtruesit të kërkesës përkitazi me mënyrën e administrimit të provave dhe ligjshmërinë e tyre nga gjykatat e rregullta, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, e cila në parim ka theksuar se, *“Ndonëse neni 6 e garanton të drejtën për një proces të rregullt, ai megjithatë nuk përcakton rregulla për pranueshmërinë e provave si të tillë, një fushë kjo që u përket për këtë arsye në radhë të parë të drejtës së brendshme dhe juridiksioneve kombëtare”* (shih, rastin GJEDNj-së [Schenk kundër Zvicrës](#), nr. 10862/84, Aktgjykimi i 12 korrikut 1988, paragrafët 45-46).
49. Megjithatë, GjEDNj ka nënvizuar se aspekti që duhet shqyrtuar në këto raste është nëse procedura, duke përfshirë edhe mënyrën se si janë mbledhur provat, ka qenë e rregullt në tërësinë e saj (shih, rastet e GjEDNj-së [Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 35394/97, Aktgjykimi i 12 majit 2000, paragrafi 34; [P.G. e J.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 44787/98, Aktgjykimi i 25 shtatorit 2001, paragrafi 76; dhe [Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 48539/99, Aktgjykimi i 5 nëntorit 2002, paragrafi 42).
50. Rrjedhimisht, nëse procedura ishte e drejtë në tërësi, duhet pasur parasysh nëse janë respektuar të drejtat e mbrojtjes. Në lidhje me këtë, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi/ja i/e kërkesës kishte mundësi ta kontestojë ligjshmërinë e provave dhe të kundërshtojë përdorimin e tyre (shih, rastin e GjEDNj-së, [Szilagyi kundër Rumanisë](#), kërkesa nr. 30164/04, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2013; shih po ashtu rastin e Gjykatës KI34/18, parashtrues *Albert Berisha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 majit 2018, paragrafi 63).
51. Më saktësisht, GjEDNj ka nënvizuar se kur prova është shumë e qëndrueshme dhe nuk vihet fare në dyshim, nevoja për prova të tjera në mbështetje të saj bëhet më e vogël (shih rastet e GjEDNj-së, [Bykov kundër Rusisë](#), [DhM], nr. 4378/02, Aktgjykimi i 10 marsit 2009, paragrafi 89, dhe referencat tjera të përmendura aty; [Jalloh kundër Gjermanisë](#), nr. 54810/00 [DhM], Aktgjykimi i 11 korrikut 2006, paragrafi 96). Rrjedhimisht, GjEDNj ka theksuar se i kushton gjithashtu rëndësi çështjes nëse prova në fjalë ka qenë apo jo përcaktuese për rezultatin e procesit penal (shih, rastin [Gäfgen kundër Gjermanisë](#), [DhM], nr. 22978/05, Aktgjykimi i 1 qershorit 2010, paragrafi 164).

b) Aplikimi i parimeve të lartcekura në rastin konkret

52. Referuar pretendimit kryesor të parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se arsyetimi për shkeljen e të drejtës së tij për “gjykim të drejtë” ndërlidhet me ligjshmërinë e marrjes së provave, respektivisht me mënyrën se si gjykatat e rregullta sipas parashtruesit të kërkesës, në kundërshtim me KPPRK, i pranuan si të mirëqena veprimet e autoriteteve të hetuesisë, gjatë kryerjes së bastisjes së shtëpisë së tij dhe objekteve përcjellëse, pa pasur një urdhër paraprak verbal dhe pa një miratim retroaktiv të urdhrin nga gjyqtarja e procedurës paraprake. Në këtë kuptim, parashtruesi i kërkesës pretendon se miratimi i një prove thelbësisht të pambështetur, si të pranueshme nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe konfirmimi i saj edhe nga gjykata e shkallës së dytë dhe e tretë, është po ashtu në kundërshtim edhe me dispozitat kushtetuese, duke iu referuar paragrafit 2, të nenit 36 të Kushtetutës.
53. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të vlerësojë ligjshmërinë e marrjes së provave nga këndvështrimi i shkeljeve kushtetuese të të drejtave të tij dhe të veprimeve paraprake procedurale gjatë grumbullimit të provave, dhe nëse veprimet e autoriteteve dhe vendimet e gjykatave të rregullta janë në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 të KEDNJ-së, në ndërlidhjeje me nenin 36.2 të Kushtetutës.
54. Në lidhje me këtë pretendim kryesor, Gjykata fillimisht i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit [P. nr. 32/2013] të 21 nëntorit 2022 të Gjykatës Themelore, e cila arsyetoi: *“Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.20.10.2022, mbrojtësi i të akuzuarit ka deklaruar, duke e kundërshtuar si formë dhe si përmbajtje – urdhërin retroaktiv për konfirmim të urdhrin verbal për kontroll konkretisht atë se si është konfirmuar ky urdhër, duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta shpallë si provë të papranueshme. (...) Trupi gjykues lidhur me propozimin e mbrojtësit pas marrjes së mendimit edhe të Prokurorit të Shtetit ka marrë Aktvendim dhe ka refuzuar propozimin e mbrojtësit ashtu siç konstatohet në procesverbalin e seancës së dt.20.10.2022, trupi gjykues ka refuzuar propozimin e mbrojtësit të akuzuarit me arsyetimin se sipas urdhrin verbal për kontroll të dhënë nga gjyqtari i procedurës paraprake pranë Departamentit për Krime të Rënda të kësaj Gjykate, e cila e ka konfirmuar me nënshkrimin e saj se ka dhënë urdhër verbal për urdhër kontroll siç konstatohet në përmbajtjen e Shënimit Zyrtar policor të përpiluar me dt.11.05.2013, në rastin konkret mungon si formë e aktit, por efekti juridik i saj konfirmohet me nënshkrimin e gjyqtarit të procedurës paraprake.*
55. Gjykata verën se parashtruesi i kërkesës nëpërmjet ankesës së parashtruar në Gjykatën e Apelit, kishte kontestuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, ndër të tjera edhe përkitazi me konstatimet e kësaj të fundit në lidhje me veprimet e autoriteteve të hetuesisë (policisë dhe prokurorisë) për kryerjen e bastisjes së shtëpisë.
56. Në këtë kontekst, në Aktgjykimin e saj Gjykata e Apelit, arsyetoi: *“... sipas vlerësimit të kësaj gjykate janë të pabazuara (pretendimet) ngase lidhur me këtë fakt gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj ka dhënë arsye në fq.3, e për të cilat arsye pajtohet edhe kjo gjykatë, si të drejta dhe ligjore ngase edhe përkundër mospërmbajtjes së formës, efekti i tij është konfirmuar gjë që rezulton nga shënimi zyrtar i cili në tërësi ka përshtuar veprimet dhe urdhrin e siguruar gojor nga gjyqtarja e procedurës paraprake dhe nga ky shënim me nënshkrim dhe vulë të gjykatës është konfirmuar pranimi i shënimit zyrtarë i përpiluar nga zyrtarët policorë të të njëjtës ditë në ora 22:00, e të dorëzuara në gjykatë në ora 22:24 min, gjë që rrjedh logjikisht kronologjia e veprimit të ndërmarrë nga*

zyrtarët policorë sipas urdhrorit gojor nga gjyqtarja e procedurës paraprake dhe raporti për njoftimin të bastisjes së kryer”.

57. Në këtë vazhdë, Gjykata po ashtu i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit të 23 shkurtit 2023 të Gjykatës Supreme, e cila për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës, se në rastin e tij është vepruar në kundërshtim me nenin 110, paragrafin 6, të KPPRK-së, si dhe me nenin 36, paragrafin 2 të Kushtetutës, arsyetoi si në vijim: *“Qëndron fakti se në këtë rast kontrolli i shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të të dënuarit Mehmet Hoti, ishte bërë pa urdhër të shkruar të gjykatës, por nga shkresat e lëndës rezulton se një gjë e tillë është bërë në bazë të lejes gojore të gjyqtarit të procedurës paraprake pasi që është vlerësuar e domosdoshme dhe e natyrës urgjente (ngutshme), për faktin se ka ekzistuar rreziku real që të asgjësohen apo të hedhen dëshmitë përkatësisht substanca narkotike. (...) Mirëpo, sipas nenit 110, paragrafi 3, të Kodit 04/L-123 të Procedurës Penale, përjashtimisht, në rrethana të ngutshme, kur urdhri me shkrim për kontroll nuk mund të merret me kohë dhe nëse ekziston rreziku real për vonesë, që mund të rezultojë me humbjen e provave (siç është situata në rastin konkret), zyrtari i autorizuar i policisë mund të fillojë kontrollin në bazë të lejes gojore nga gjyqtari kompetent. Po ashtu, shmangie nga rregulla e lartcekur është e parashikuar edhe në nenin 36, paragrafi 2, fjalia e dytë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në këtë dispozitë kushtetuese është parashikuar se "Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligj". (...) Në pjesën e fundit të shënimit Zyrtar, shihet se ky raport është pranuar nga gjyqtarja e procedurës paraprake me datën 11 maj 2013, në ora 22:24 minuta dhe gjyqtarja në fjalë ka shënuar se e konfirmon se ka dhënë urdhër gojor për kontroll. Po ashtu, nga Shënimi Zyrtar, shihet se ky konfirmim i gjyqtarës së procedurës paraprake është pasuar edhe me nënshkrimin e saj dhe me vendosjen e vulës së Gjykatës Themelore në Mitrovicë.*
58. Në dritën e parimeve të përgjithshme të GJEDNj-së, siç janë elaboruar më lart dhe bazuar në arsyetimet specifike të gjykatave të rregullta, Gjykata vlerëson se në rastin e parashtruesit të kërkesës gjykatat e rregullta kanë nxjerrë vendimet e tyre në përputhje me standardet e kërkuara të së drejtës për gjykim të drejtë. Kjo për faktin se vendimmarrja e tyre ishte e bazuar në prova të pakontestuar. Gjykata po ashtu vëren se Gjykata Supreme, kishte adresuar në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të detajuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës, “se një provë e pranuar në mënyrë të kundërligjshme, nuk mund të merret si e pranueshme”, duke arsyetuar: *“... se në rastin konkret kemi një konfirmim të gjyqtarit të procedurës paraprake që është konstatuar në Shënimin Zyrtar, i cili konfirmim, edhe pse në formën jo të duhur, e ka efektin juridik të aprovimit retroaktiv të kontrollit dhe atë për dy arsye: Së pari, për faktin se paraprakisht lejen gojore për kontrollin e shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të të dënuarit Mehmet Hoti, e kishte dhënë gjyqtarja e njëjtë që e kishte konfirmuar më pastaj këtë fakt; dhe Së dyti, konfirmimi që është bërë i referohet përshkrimit të ngjarjes që është bërë në Shënimin Zyrtar e që do të kishte efektin e njëjtë sikurse të një akti të shkruar formal nga ana e gjyqtarit të procedurës paraprake”.*
59. Prandaj, bazuar në arsyetimin si më sipër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij për “gjykim të drejtë, si rezultat i marrjes dhe i pranimit të paligjshëm të provave. Për më tepër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk bëhet fjalë as për shkelje të “privatësisë” sipas kuptimit të nenit 36 të Kushtetutës, meqë nuk u vërtetua pretendimi i ngritur për veprime joligjore dhe jokushtetuese nga ana e autoriteteve përkatëse, përgjatë fazës së grumbullimit të provave.

Në këtë aspekt, Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GjEDNj-së [Mezotur-Tiszazuqi Tarsulat kundër Hungarisë](#), nr. 5503/02, Aktgjykim i 26 korrikut 2005, paragrafi 21).

60. Gjykata e konsideron të rëndësishme të përsëris qëndrimin e përgjithshëm se “drejtësia” e kërkuar nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së nuk është drejtësi *substanciale*, por drejtësi *procedurale*. Në rrafshin praktik, koncepti i drejtësisë procedurale nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin e tyre; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNj-së [Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës](#), nr. 10590/83, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastin e Gjykatës [KI22/19](#), me parashtrues: [Sabit Ilazi](#), Aktvendimi i 7 qershorit 2019, paragrafi 42 dhe rastet e cituara aty, po ashtu rastin [KI98/21](#), cituar më sipër, paragrafin 59).
61. Referuar paragrafit të mësipërm, Gjykata thekson se në rrethanat e rastit konkret janë respektuar të gjitha kriteret e lartcekura, për arsye se, si parashtruesi i kërkesës po ashtu dhe mbrojtësi i tij janë dëgjuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat e rregullta dhe kanë pasur mundësi që përgjatë gjithë procedurës t’i kundërshtonin provat kundër tyre. Megjithatë, duket se parashtruesi i kërkesës nuk është pajtuar me vendimin e gjykatave për sa i përket cilësimit të veprës penale dhe me lartësisë së dënimit të shqiptuar. Gjykata edhe më tej thekson se është në diskrecionin e plotë të gjykatave të rregullta të bëjnë cilësimin e veprës penale dhe të shqiptojnë masën e duhur të sanksionit penal në raport me faktet e vërtetuara dhe provat e administruara.
62. Për më tepër, shikuar në tërësinë e saj procedura e zhvilluar pranë instancave gjyqësore në dritën e rrethanave të rastit konkret nuk ishte e padrejtë ose arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, GjEDNj, rastin, [Garcia Ruiz kundër Spanjës](#), nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafët 29 dhe 30; shih gjithashtu rastet e Gjykatës, [KI128/18](#), parashtrues; [Limak Kosovo International Airport SH.A.](#), “*Adem Jashari*”, Aktvendimi i 27 majit 2019, paragrafi 58, [KI22/19](#), parashtrues: [Sabit Ilazi](#), Aktvendimi i 7 qershorit 2019, paragrafi 42, dhe [KI98/21](#), cituar më lart, paragrafi 69).
63. Thënë këtë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 të KEDNj-së, si rezultat i kësaj dhe pretendimet për nenin 36 të Kushtetutës, kualifikohen në kategorinë e tretë (iii) të pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, sepse në baza kushtetuese të njëjtat janë qartazi të pabazuara.

ii. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me pretendimet tjera

64. Në vlerësimin e pretendimeve tjera, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, përveç pretendimit kryesor për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë nga gjykatat e rregullta, pretendon dhe në shkelje të neneve 54 dhe 55 të Kushtetutës. Gjykata përsërit se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës dhe e neneve të instrumenteve a konventave që janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në rendin juridik të Republikës së Kosovës ose ndërlidhja e tyre me një nen tjetër të Kushtetutës nuk nënkupton me automatizëm edhe shkelje të atyre

neneve, në qoftë se më tej nuk argumentohet dhe shtjellohet se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e tyre.

65. Gjykata vazhdimisht ka theksuar se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe KEDNj-së, si dhe të instrumenteve tjera ndërkombëtare, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: [KI175/20](#), me parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; dhe së fundmi rastin [KIO4/21](#), me parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).
66. Për këto arsye, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të neneve 54 dhe 55 të Kushtetutës, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”, andaj në baza kushtetuese të njëjtat janë qartazi të pabazuara.

Lidhur me kërkesën për masë të përkohshme

67. Gjykata në këtë kontest, rikujton se ajo vetë ose me kërkesë të palës mund të vendos masë të përkohshme, në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 27 të Ligjit, që përcaktojnë: “1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të riparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik. 2. Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale”.
68. Siç është cekur në fillim, parashtruesi i kërkesës nëpërmjet kësaj kërkesë, kërkon nga Gjykata që të vendos masë të përkohshme për të evituar rrezikun e dëmeve të riparueshme që do t'i shkaktohej atij nga shkuarja në vuajtje të dënimit. Megjithatë, Gjykata sa më sipër, konkludoi se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është qartazi e pabazuar dhe rrjedhimisht e papranueshme. Prandaj, duke qenë kështu, Gjykata në pajtim me paragrafin 1 të nenit 27 (Masat e përkohshme) të Ligjit dhe me rregullin 57 (Vendimi për masë të përkohshme) të Rregullores së punës, konsideron se kërkesa për masë të përkohshme është pa objekt shqyrtimi dhe si e tillë e njëjta refuzohet.

Përfundim

69. Si përmbledhje e të gjitha shtjellimeve dhe analizave të mësipërme, Gjykata konkludon se: (I) pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, nenit 6.1 të KEDNj-së, si rezultat dhe ato për shkelje të nenit 36 të Kushtetutës, i takojnë kategorisë së tretë (iii) të pretendimeve të “*pambështetura apo të paarsyetuara*” andaj, si të tilla, të njëjtat në baza kushtetuese shpallen qartazi të pabazuara; (II) pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 54 dhe 55 të Kushtetutës, i takojnë kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve të “*pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj të njëjtat në baza kushtetuese, gjithashtu duhet shpallur qartazi të pabazuara.
70. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit të kërkesës, në tërësinë e saj, duhet deklaruar e papranueshme, në pajtueshmëri me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7, 116.2 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 27 të Ligjit, me rregullat 39 (2), 54 , 55 dhe 59 (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 22 maj 2023, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË, kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani